UNIVERSITETI I MITROVICËS
'ISA BOLETINI'

| Programi mësimor i lëndës (Syllabusi) | | |
|---|---|---|
| **Fakulteti:** | Fakulteti Ekonomik | |
| **Programi/Departamenti:** | Biznes dhe Menaxhment/Specializimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet | |
| **Niveli:** | Bachelor | |
| **Kodi i lëndës:** | 05B02S01001 | |
| **Lënda:** | Mikroekonomi | |
| **Statusi i lëndës:** | | Obligative |
| **Semestri:** | | Dimëror |
| **Fondi i orëve:** | 3+2 | Sipas programit të aprovuar |
| **ECTS:** | 8 | Sipas programit të aprovuar |
| **Orari/Salla** | | |
| **Viti akademik:** | Viti i I, Semestri i I | |
| **Mësimdhënës/e:** | Prof. Ass. Dr. Filloreta Kunoviku Demiri | |
| **Asistent/e:** | Arif KRASNIQI, Msc | |
| **Kontaktet:** | Mësimdhënës/e | Asistent/e |
| E-mail: | filloreta.demiri@umib.net | arif.krasniqi@umib.net |
| Telefon: | + 383 (0) 45 701 789 | + 383 (0) 49 494 031 |

| | |
|---|---|
| **PERMBAJTJE** | Ky modul do të trajtojë njohjen e studentëve me konceptet themelore lidhur me mikroekonominë. Në veçanti, ky kurs synon të analizojë këto çështje: konceptet e Ekonomiksit, kërkesën dhe ofertën, elasticitetin e kërkesës dhe ofertës, firmat dhe llojet e tyre, sjelljen konsumatore, monopolin, koston dhe përcaktimin e çmimeve në konkurrencë të plotë etj. Diskutimi i temave të tilla mundëson analizimin e çështjeve të tilla si ekuilibri dhe disekuilibri i kërkesës dhe ofertës, efektet në treg të ndryshimeve në kërkesë dhe ofertë, shpërndarja e të ardhurave, tregu i faktorëve të prodhimit, zgjedhja konsumatore, konkurrenca e plotë dhe eficenca ekonomike etj. |
| **QËLLIMI** | Ky modul ka për qëllim që tu ofrojë studentëve njohuri për konceptet themelore mikroekonomike në lidhje me funksionimin e Ekonomisë si dhe politikat ekonomike të zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare, njohjen e studentëve me mënyrën se si ekonomistët përballen me problemet, të mësojnë mjetet që përdoren prej ekonomistëve në zgjidhjen e problemeve, sigurimin e një përmbledhjeje të diskutimeve të vazhdueshme në lidhje me zhvillimet aktuale. |

<table>
<tr><td>ARRITSHMËRIA</td><td colspan="2">

❑ **Me kompletimin e lëndës, studentët do të jetë në gjendje të:**

1. **<u>Përshkruajnë</u>** rolin e ekonomiksit në raport me shkencat e tjera ekonomike si baza teorike e shkencave ekonomike dhe si një shkencë që studion marredhëniet ekonomiko-shoqërore midis vendim-marrësve.
2. **<u>Kuptojnë</u>** ambientin ekonomik, politik dhe ligjor të mikroekonomisë;
3. **<u>Diskutojnë</u>** për kornizën bazë të mikroekonomisë,
4. **<u>Argumentojnë</u>** rolin e dy parametrave bazë të tregut siç janë kërkesa dhe oferta me qëllim identifikimin e punës së tregjeve,
5. **<u>Konceptojnë</u>** situatën ekuilibër në treg si një situatë specifike drejtë të cilës tenton tregu për çdo produkt dhe
6. **<u>Krijojnë</u>** aftësi për proceset globale dhe strategjike si dhe të përshkruajnë ndikimin e biznesit global në ndërmarrjet dhe ekonomitë nacionale.

</td></tr>
<tr><td rowspan="16">PROGRAMI</td><td>Javët</td><td>Tema</td></tr>
<tr><td>Java - I</td><td>Përmbajtja dhe njohja me lëndën (Syllabusi)</td></tr>
<tr><td>Java - II</td><td>Hyrje në Ekonomiks</td></tr>
<tr><td>Java - III</td><td>Kërkesa & Oferta</td></tr>
<tr><td>Java - IV</td><td>Elasticiteti i Kërkesës dhe Ofertës</td></tr>
<tr><td>Java - V</td><td>Ekuilibri & Disekuilibri</td></tr>
<tr><td>Java - VI</td><td>Firma, Shperndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorve te prodhimit</td></tr>
<tr><td>Java - VII</td><td>Sjellja konsumatore</td></tr>
<tr><td>Java - VIII</td><td>Kollokviumi i Parë</td></tr>
<tr><td>Java - IX</td><td>Firmat dhe Kostoja</td></tr>
<tr><td>Java - X</td><td>Përcaktimi i çmimeve në konkurencë të plotë</td></tr>
<tr><td>Java - XI</td><td>Monopoli</td></tr>
<tr><td>Java - XII</td><td>Forma të tjera të konkurencës së plotë</td></tr>
<tr><td>Java - XIII</td><td>Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit</td></tr>
<tr><td>Java - XIV</td><td>Teoria e prodhimit dhe produktit margjinal</td></tr>
<tr><td><u>Java - XV</u></td><td>Kollokviumi i Dytë</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **LITERATURA** | **Literatura themelore:**<br><br>1. Gregory N. Mankiw dhe Teylor M.P.(2012). *Ekonomiksi – Mikroekonomia. Botimi në Shqip, Tiranë 2012.*<br>2. Ahmet Mancellari, Sulo Haderi, Dhori Kule, Stefan Qirici (2007). *"Hyrje në Ekonomi",, Tiranë 2007.*<br><br>**Literatura plotësuese**:<br><br>*1.* David C. Colander, (2020). *Microeconomics: Eleven Edition – Published by McGraw- Hill Education 2020*<br>*2. Prezentimi nga ligjerata do të shperndahet tek studentët* |
| **METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS** | Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 3 orë ligjërata dhe 2 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfiume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jipen pas çdo ligjerate për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake.<br><br>Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, gazeta ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Konsultime me mësimdhënësin/asistenten | 1 | 15 | 15 |
| Kolokiume /seminare | 2 | 2 javë | 4 |
| Detyra të pavarura | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 5 | 15 javë | 75 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 4 | 6 javë | 24 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final | / | / | / |
| Projektet, prezantimet, etj | 2 | 5 javë | 10 |
| **Totali** | | | **203 orë= 8 ECTS** |

| | |
|---|---|
| **VLERËSIMI** | **Metodat e vlerësimit**<br>Vlerësimi në %<br>Testi i –I-rë, me shkrim ....................................25%<br>Testi i – II-të, me shkrim ..................................25%<br>Aktiviteti në klasë ..............................................10%<br>Punime seminarike.............................................10%<br>Povimi final .........................................................30%<br>**Shkallët e notave** :<br>50-me pak – nota 5 (pesë)<br>51-60 % - nota 6 (gjashtë)<br>61-70 % - nota 7 (shtatë)<br>71-80 % - nota 8 (tetë)<br>81-90 % - nota (nëntë)<br>91-100 % - nota (dhjetë) |
| **POLITIKAT AKADEMIKE** | Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjerate. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit. |

**Mitrovicë**

**Bartës/e i/e lëndës:**

**Prof. Ass. Dr. Filloreta KUNOVIKU DEMIRI**

19/12/2021

____________________________

(Emër Mbiemër)

____________________________

(Nënshkrimi)